



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
Bul.Gjergj Fishta Tirana, Albania, Tel +355 4 230 369

47 prot

19.1.2018

**Marrëveshje Bashkëpunimi
midis**

Fakultetit të Shkencave Sociale, Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale

(Universiteti i Tiranës)

dhe

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTAT E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT
(Emri i Institucionit)

X. Shkurti,
Per marrëveshje

Kjo marrëveshje realizohet sot, më datë 16 / 10 / 2017, midis Fakultetit të Shkencave Sociale, Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale (Universiteti i Tiranës), që tani e tutje i quajtur si "Fakulteti" dhe AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTAT E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT që tani e tutje i quajtur si "Institucioni".

Palët kanë rënë dakord që Institucioni do të ofrojë mundësinë që studentët e programit Master të Fakultetit:

1. ASUNTA TORORËNI
2. ILDA KENIA.
3. _____
4. _____

të kryejnë Praktikën Mësimore, sipas procedurave të paracaktuara prej Fakultetit dhe Institucionit.

Numri i studentëve që do të zhvillojnë Praktikën Mësimore në një Institucion përcaktohet nga vetë Institucioni. Përfaqësuesit e Fakultetit dhe Institucionit duhet të bashkëpunojnë në lidhje me metodat e zhvillimit të praktikës, objektivat që duhet të arrijnë studentët si dhe detaje të tjera të lidhura me zhvillimin e Praktikës Mësimore.

Fakulteti cakton një anëtar të stafit mësimor të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme Praktikën Mësimore të studentëve sipas institucioneve të paracaktuara. Pedagogu/ia i/e Fakultetit mban përgjegjësinë për zgjedhjen e studentëve dhe realizimin e detyrave të tyre gjatë Praktikës Mësimore.

Studentët duhet të ndjekin dhe zbatojnë rregullat, politikat dhe procedurat e Institucionit në të cilin realizojnë Praktikën Mësimore. Në rast problemesh, pedagogu/ja i/e përkatës/e duhet të njoftohet menjëherë dhe të tilla probleme duhet të zgjidhen në mirëkuptim midis palëve (përfaqësuesve të Fakultetit t dhe Institucionit).

Institucioni është i detyruar t'u ofrojë studentëve një seancë orientimi ku ata/ato të mund të njihen me të, me stafin e tij si dhe politikat e Institucionit dhe çështje të tjera administrative. Institucioni duhet të caktojë një anëtar/e të stafit që të ketë njohuritë edhe përvojën për të realizuar rolin e supervizorit/es për studentët praktikantë.

Pedagogu/ia si përfaqësues/e i Fakultetit dhe supervizori/a i Institucionit, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, do të vlerësojnë punën dhe rezultatet e studentëve gjatë praktikës mësimore.

Fakulteti dhe Institucioni nuk do të diskriminojnë asnjë student për shkaqe të tilla, si: raca, seksi, etnia, besimi fetar, orientimi seksual, bindjet politike, kombësia, mosha, aftësitë e kufizuara apo statusi martesor.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën 16.10.2017 dhe përfundon në datë 09.02.2018.

Për Fakultetin

Dekani Prof.Dr. Edmond RAPTI



, data _____

Përgjigjësi i Departamentit Prof.Asoc.Dr. Rudina RAMA

Firma

, data _____

Për Institucionin:

Emri

Antiana Lube

Titulli (pozicioni)

Kryetare

Firma, vula

[Signature], data 18 Jan. 18

